

20. SUNIL SHARMA



20. SUNIL SHARMA jeton në Toronto (Kanada). Atij i pëlqen shumë të dëgjojë simfonitë e zogjve, erërat e oqeanëve, të lumenjve dhe të shikojë qiellin dhe yjet për bukurinë e tyre eterike. Ai është gjithashtu mjaft adhures i fjalëve: përmbledhës tingujsh, kuptimesh dhe imazhesh të pakapshme. Deri tani, ka botuar 27 libra krijimesh dhe kritikash. Sunil është fitues i çmimit Golden Globe Award-2023 dhe i Nissim Award for Excellent Prose (2022), me romanin politik "Minotaur". Poezitë e tij janë përfshirë në projektin prestigjioz të Kombeve të Bashkuara: Lumturia: The Delight-Tree: Anthology of Contemporary International Poetry, (2015). Sunil është redaktor i revistës mujore SETU JOURNAL (Kanada).

TEATRI

Pafundësia e qiellit
vështrim që nuk pengohet
nga mungesa e grumbujve të rrokaqiejve,
standarde në qytete gjigante
këtu, në rrethinat e Torontos,
i pafund në kohë reale është qielli.
Ndrojtje!
këtë mëngjes në fund të dhjetorit,
plot me re,
të gjitha zbresin poshtë
masa me gri të errët dhe gri të kthjellëta
kundrejt një kaltërsie të mrekullueshme.
Ja pse ndihesh
pjesë e një spektakli kozmik!

FLUTURIMI I PATAVE

Rreth një mbrëmjeje të qetë,
me fytyrë të nxirë,
ndërsa erërat ngadalë kërcejnë,
një grua,
ngarkuar me dy çanta me ushqime,
përgjatë Gore Drive,
në gjysmë të rrugës ndalon.
E habitur mbetet
nga fluturimi i patave
njolla kafeje të errëta,
që në sinkronizim perfekt
në grupe të mëdha fluturojnë.
E hipnotizuar si fëmijë ngel
prej kësaj panorameje hyjnore!

FËMIJA

Një fëmijë duke ecur nëpër rrugë pashë
në një natë vetmie.

Trafiku ishte i shpejtë
shtëpitë ndriçuar mirë
në komunitetet e vogla

në Bulevardin Cottrell.

Një erë papritmas fryu
errësirën dendëson,
dhe fëmija mbrapa vetes
plakun vështron,
larg nga shtëpia në Delhi
duke e trembur me këtë shfaqje të papritur
në atë pasarelë të gjatë!
Rininë e vetvetes së tij sërish gjen
atje duke ecur,
si një alien në një kënd të tokës.